



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština Štrpce-Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

Në mbështetje të nenit 11, 12, të Ligjit nr. 03/ L - 040 për vetëqeverisjen Lokale , te Udhezimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018, për Transparence ne Komuna, Rregullores per Transparence te komunës se Shtërpçës 01-Nr 895 te datës 14.07.2010 , si dhe neneve 15 dhe 34 të Statutit të komunës së Shtërpçës 01-Nr. 898 të datës 14.07.2010, si dhe Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 26.12.2019 morri këtë:

VENDIM
PËR
VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK TË PROPOZIM VENDIM
PËR INICIMIN E PROCEDURES PER NDRYSHIMIN E STATUTIT TE
KOMUNES SE SHTERPCES

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet propozim “Propozim vendimi për ndryshimin e statutit te Komunës se Shtërpçës” dhe si PROPOZIM, vihet në diskutim publik.

Neni 2.

Debati publik rreth propozim “Propozim vendimi per ndryshimin e statutit te Komunës se Shtërpçës” do te zgjasë se paku 30 dite nga dita e publikimit te ketij vendimi ne tabelen e shpalljeve dhe ne web faqen e komunës se Shtërpçës ndërsa debati me qytetare do te caktohet nga ana e zyrës për informim.

Neni. 3

Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshime mund te paraqiten ditën e mbajtjes se debatit publik si dhe gjat kohëzgjatjes se debatit publik ne zyrat e per informim publik.

Neni.4

“Propozim vendimi per ndryshimin e statutit te Komunës se Shtërpçës” është pjese perberese e këtij vendimi dhe publikohet ne ueb-faqen zyrtare te komunës se Shtërpçës.

Neni 5.

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve publike dhe në Web-faqen e KK të Shterpces.

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS	
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTERPCËS	
02/Br.Prot.	IZLAZNI - DALËSE
Nr.Prot.	02-030101-18158/19
Gr.str.	2
Nr. l. fq.	
Datum	12-12-2015
Data	
ŠTRPCE - SHTERPCË	



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština štrpce
Komuna e Shtërpcës
Municipality of Strpce

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 66 dhe 92 paragrafi 92.1 pika (a) të Statutit të Komunës së Shtërpcës nr 01/898 të datës 14/07/2010 Kryetari i Komunës së Shtërpcës në nxjerre këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR INICIMIN E PROCEDURES PER NDRYSHIMIN E STATUTIT TE KOMUNES SE
SHTERPCE

Neni 1

Neni 1 Statuti i Komunes i Komunes se Shterpces , ndryshohet dhe plotdsohet: 69 paragrafi 69.1 duke shtuar “9. Drejtoria e inspektoratit.”

Neni 2

Pas nenit 77 shtohet nje nen i ri 77A dhe ate siq vijon:

Drejtoria e Inspektoratit

Drejtoria e inspeksionit është organ i administratës ,fushë-veprimtaria e së cilës është përcjellja ,monitorimi dhe marrja e masave ,përmes vendimeve administrative ,në funksion të mbikëqyrjes inspektuese ,të fushave të rregulluara me ligje ,akte nënligjore ,vendime dhe urdhëresa në fuqi .

Detyrave dhe përgjegjësit e Drejtorise se Inspektoratit:

- Kryen inspektime në mbështetje te ligjit për fushat e ndryshme,
- Bën inspektimin e ndërtimeve të objekteve të ndërtimit kolektiv, privat, objekteve afariste, rrugëve dhe kanalizimeve të ujërave fekale,
- Kryen inspektimin ne fushën sanitare në mbështetje te ligjit përkatës,
- Kryen inspektimin nga fusha e veterinës në mbështetje te ligjit përkatës,
- Kryen inspektimin në fushën e mbrojtjes se ambientit në mbështetje të ligjit përkatës,
- Kryen inspektimin e veprimtarive ekonomike dhe bizneseve të ndryshme në Komunë duke kontrolluar të gjitha bizneset e regjistruara dhe ato te cilat janë të pa regjistruara dhe ndërmerr veprimet përkatëse ligjore,
- Kryen inspektimin financiar, inspektimin e tregut dhe çmimeve në pajtim më ligjin përkatës,
- Kryen inspektimin nga lëmi i bujqësisë në pajtim më Ligjin përkatës,
- Kryen inspektimin e shërbimeve komunale: rrugëve, shesheve, parqet, varrezat, përcjellja

e trafikut të auto-taksive, kombi-taksi, autobusëve dhe automjeteve për transport, reklamat e ndryshme të bizneseve dhe të tjera,

- Kryen inspektimin e pronave ku sigurohet zbatimi i ligjeve të pronës e po ashtu edhe të ligjeve dhe të rregulloreve të tjera të lidhura me pronën dhe mjedisin,
- Kryen inspektimin rreth parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri si dhe fatkeqësive të tjera elementare,
- Kryen punë dhe përgjegjësi të tjera nga lëmi i vet, të përcaktuara nga Kryetari dhe në mbështetje në ligjet përkatëse.

Neni 3

Obligohet Drejtoria e Administratës së Përgjithshme që të njëjtën ta procedojë për shqyrtim, në KPF – së me propozim që pas miratimit t ia procedojë për shqyrtim, Kuvendit të Komunës për marrjen e vendimit për hapjen e debatit publik

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kryetari i Komunës së Shtërpçës.

Vendimi u dorëzohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
2. Zyrës së Kryetarit dhe
4. Arkivit.

Kryetari i Komunës
Bratislav Nikolic

